

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shërbim Gatimi dhe shpërndarje ushqimi, ndarë në 2 (dy) lote, si më poshtë:

Loti 1: “Gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Catering) në S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë””

Loti 2: “Shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për Spitalin Universitar të Traumës”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) 15894220-9

VLERA E FONDIT LIMIT: 402,593,295.64 (katërqind e dy milion e pesëqind nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë pike gjashtëdhjetë e katër) lekë pa tvsh ose 4,104,744.04 (katër milion e njëqind e katër mijë e shtatëqind e dyzet e katër pikë zero katër) Euro pa TVSH, ndarë në 2 (dy) lote si më poshtë:

Loti 1: “Gatimi dhe shpërndarje ushqimi (Catering) në S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë””, me fond limit 185,219,458 (njëqind e tetëdhjetë e pesë milion e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa tvsh ose 1,888,452.88 (Një milion e tetëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy pikë tetëdhjetë e tetë) Euro pa TVSH

Loti 2: “Shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për Spitalin Universitar të Traumës”, me fond limit 217,373,837.64 (dyqind e shtatëmbëdhjetë milion e treqind e shtatëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tridhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë e katër) lekë pa tvsh. ose 2,216,291.17 (Dy milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e një pikë shtatëmbëdhjetë) Euro pa TVSH

(Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (98.08), datë 18.06.2025, ora 12:44)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

LOTI 1: “GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI (CATERING) NË S.U.O.GJ “MBRETËRËSHA GERALDINË”

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, (katering). Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik (në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) apo disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore.

Në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licencuar, sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nën ligjore.

Licenca dhe kategoria, e përcaktuar si kriter më sipër është në përputhje dhe lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet dhe cilësinë e shërbimit, që kërkon të ofrohet nëpërmjet kësaj kontrate.

2.1.2 Operatorët ekonomikë, duhet të posedojnë të paktën një stabiliment të licensuar për prodhimin e ushqimit. Ky stabiliment duhet të jetë brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër. Objekti mund të jetë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratë qiraje ose përdorimi, ku të identifikohet dhe vendndodhja brenda bashkisë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për disponimin e një stabilimenti të licensuar, është vendosur bazuar në nenin 19 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në

ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

Duke qenë se ushqimi duhet të jetë i gatuar rishtaz, vendodhja e stabilimentit brenda territorit të bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër, siguron gatimin dhe shpërndarjen e gatimit, në kohë, brenda standarteve dhe kërkesave të cilësisë të kërkuara. Siguria ushqimore në këtë procedurë prokurimi është një kërkesë jo vetëm teknike, por një detyrim ligjor dhe etik për të mbrojtur shëndetin e pacientëve. Transporti në distanca të gjata rrit ndjeshëm rrezikun e kontaminimit mikrobiologjik për shkak të humbjes së kontrollit mbi temperaturën, kohën e qëndrimit, sidomos në raste të trafikut, bllokimeve, kushteve atmosferike etj. Distanca e kërkuar siguron një monitorim më efikas të kontratës./ave që do të lidhen, si dhe menaxhimin e më efektiv dhe të shpejtë të rasteve urgjente që mund të lindin.

Nga ana tjetër, stabilimenti brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër, ndikon në reduktimin e ndotjes së ajrit, pasi transporti më i shkurtër sjell më pak ndotje, më pak emetime CO₂ në mjedis.

Njesia e prokurimit gjykon që në çdo rast duhet të kërkohej të paktën një stabiliment brenda bashkisë ku zbatohet kontrata, edhe në rastin kur shërbimi i gatimit mund të kryhet në ambientin e spitalit, pasi garantohej vazhdimësia e shërbimit edhe eksperiencia e ofertuesit në lidhje me kriteret e licensimit dhe kushtet ligjore dhe teknike që duhet të ketë një ambient ku gatuhet ushqim, vecanërisht për një target grup specifik siç janë pacientet e spitalit.

2.1.3 Operatorët ekonomikë, duhet të paraqesin një deklaratë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor, duhet të paraqesë Aktin e kontrollit të fundit të realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), ku ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”....”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, si dhe bazuar në objektin e prokurimit, në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018, me qëllim që AK të krijojë siguri se ofertuesi gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij plotëson kushtet ligjore, të lidhura me objektin e prokurimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të

plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se disponon dhe të paraqesë certifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

SH EN ISO 22000:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

S SH EN ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

SSH EN ISO 14001:2015 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

SH EN ISO 22000:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme është vendosur bazuar në rekomandimin e përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018, me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të sigurisë ushqimore.

Duke qenë se ky standart specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të sigurisë ushqimore për të mundësuar një operator, që është i përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në zinxhirin ushqimor: të planifikojë, zbatojë, operojë, mirëmbajë dhe përditësojë një sistem që ofron produkte dhe shërbime që janë të sigurta, në përputhje me përdorimin e tyre të synuar, për të demonstruar pajtueshmërinë me kërkesat e aplikueshme statutores dhe rregullatore të sigurisë ushqimore, të vlerësojë kërkesat e klientëve për sigurinë ushqimore të miratuara reciprokisht dhe të demonstrojë konformitetin me to, të komunikojë në mënyrë efektive çështjet e sigurisë ushqimore palëve të interesuara brenda zinxhirit ushqimor; etj.;

Si dhe duke vlerësuar që të gjitha kërkesat e këtij dokumenti janë të përgjithshme dhe synohen të zbatohen për të gjitha organizatat që janë të përfshira drejtpërdrejt ose tërthorazi, në zinxhirin ushqimor, pavarësisht nga madhësia dhe kompleksiteti;

Kërkesa e mësipërme lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, duke krijuar siguri që shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit do të kryhet konform standarteve të kërkuara, dhe operatori

ekonomik është i aftë të identifikojë rreziqet për sigurinë ushqimore, i vlerëson ato dhe vendos masa kontrolli për t'i eliminuar apo minimizuar. Disponimi i këtij standarti garanton AK se ofertuesi ka një sistem të dokumentuar, të monitoruar dhe të auditueshëm për identifikimin dhe kontrollin e rreziqeve ushqimore, menaxhimin e pikave kritike të kontrollit (HACCP), trajnimin e personelit dhe monitorimin e higjenes. Në rast të një incidenti ushqimor, një ofertue si pajisur me këtë standart reagon më shpejt, ka sisteme gjurmueshmërie të menjëhershme për përbërësit dhe proceset, minimizon pasojat për pacientët dhe për autoritetin kontraktor.

S SH EN ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme vlerësohet një standart i rëndësishëm për tu disponuar nga ofertuesit i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit.

Duke qenë se shërbimi objekt prokurimi përfshin përgatitje intensive të vakteve në kuzhinë, proces i cili paraqet rrezik nga mjetet prerëse, zjarri, avujt, temperatura të larta, kimikatet e pastrimit, transport të përditshëm të ushqimeve dhe shpërndarje në ambiente spitalore, procese ku kërkohen standarte të larta higjene dhe mbrojtje nga kontaminimi, etj., pajisja me këtë standart siguron AK që ofertuesi ka procedura të qarta për menaxhimin e rreziqeve fizike dhe mjedisore, zbaton masa parandaluese për të shmangur aksidente në punë, si dhe organizon trajnime për sigurinë e punonjësve. Ky standart siguron AK gjithashtu se ofertuesi ka një strukturë të mirëorganizuar për menaxhimin e ngjarjeve të papritura, duke ruajtur vazhdimësinë e shërbimit.

SSH EN ISO 14001:2015 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme siguron AK që ofertuesi ka procedura për menaxhimin dhe reduktimin e mbetjeve, si dhe për ruajtjen e pastërtisë së ambientit, pasi aktivitetet e gatimit dhe shpërndarjes krijojnë mbetje (organike, plastike, vajra të përdorur, detergjentë etj.). Ky standart nxit gjithashtu përdorimin e energjisë, ujit dhe lëndëve të para në mënyrë të qëndrueshme, duke ulur kostot dhe ndikimin ekologjik.

2.3.3 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të kenë jo më pak se 10 (dhjetë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjësve
1.	Mercolog/Kimist/Teknolog Ushqimor <u>(Agroushqimor)</u>	1
2.	Kuzhinier	1
3.	Ndihmës Kuzhinier	1
4.	Punonjës shpërndarës ushqimesh në ambientet e AK	6
5.	Shofer	1
	Total	10 (dhjetë)

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, për Mercolog/Kimist/Teknolog Ushqimor (Agroushqimor), Kuzhinierin, Ndihmës Kuzhinierin, Punonjës shpërndarës ushqimesh në ambientet e AK.

a) Mercolog/Kimist/ Teknolog Ushqimor (Agroushqimor):

- Diplomë me profesionin perkates;
- Kontratë pune (e vlefshme),

- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite.

b) Për Kuzhinierin:

- Diplomë ose certifikatë kualifikimi për kuzhinier në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional,
- Kontratë pune si kuzhinier, (e vlefshme)
- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite.

c) Për ndihmës kuzhinierin:

- Kontratë pune si ndihmës kuzhinier, (e vlefshme)
- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 1 një vit.

d) Për punonjësit për shpërndarje ushqimi të paraqitet:

- Kontratë pune si shpërndarës ushqimi (e vlefshme).

dh) Për punonjësit Shofer, të paraqitet:

- Kontratë pune si shofer, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi, për mjetin e kërkuar, në përputhje me Legjislacionin në fuqi

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës hartuar nga AK, për llogari të së cilit po zhvillohet procedura e prokurimit. Operatorët ekonomik, me anë të stafit të kërkuar, do të kryejnë në mënyrë shteruese shërbimin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit per Spitalin.

Referuar sa më sipër, operatori ekonomik duhet të disponojë një mercollog/kimist/teknolog ushqimor (agroushqimor), i cili ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimit të perzgjedhjes se ushqimeve sipas kerkesave te Specifikimeve Teknike. Një punonjës me një profil të tillë vlerësohet i nevojshëm pasi ka ekspertizë profesionale në zinxhirin ushqimor, për të menaxhuar procesin e përpunimit të ushqimit, ruajtjen dhe magazinimin, trajtimin termik, etiketimin dhe përbërësit, si dhe kontrollin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore. Duke qenë se ndër proceset e objektit të prokurimit, përfshihet gatimi, kuzhinieri dhe ndihmës kuzhinieri janë të lidhur ngushtë me zbatimin e këtij procesi dhe përgatitjes së dietave të përcaktuara në DST. Punonjësit për shpërndarje ushqimi dhe shoferi, lidhen ngushtë me procesin e transportit, shpërndarjes së ushqimit në oraret e përcaktuara nga AK.

Vitet e eksperiencës për mercollog/kimist/teknolog ushqimor (agroushqimor), kuzhinierin dhe ndihmës kuzhinierin janë vendosur duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e shërbimit, objekt prokurimi. Vitet e eksperiencës për secilin janë minimale dhe sigurojnë AK që këta punonjës që do të angazhohen për këtë procedurë prokurimi kanë eksperiencën e duhur për të përgatitur dietat përkatëse, sipas përshkrimit të tyre, në kohë dhe me cilësinë e kërkuar.

Përvoja e mëparshme për mercollog/kimist/teknolog ushqimor (agroushqimor) dhe kuzhinierin, të paktën 2 vite, lidhet me aftësinë në menaxhimin e një kuzhine, e cila është komplekse se një kuzhine standarte, për shkak të dietave të personalizuar. Nga ana tjetër kjo eksperiencë garanton AK se këta punonjës kanë njohuri të mjaftueshme për planifikimin e menusë, logjistikën e shërbimeve, optimizimin e burimeve (si ushqime, staf, pajisje) dhe kontrollin e cilësisë së ushqimit, si elementë thelbësorë në zbatimin e objektit të prokurimit. Përvoja e mëparshme, të paktën 2 vite, siguron AK se këto punonjës kanë aftësi menaxheriale, të cilët janë të aftë të zgjidhin situatat emergjente që mund të krijohen. Mungesa e eksperiencës dhe një përvojë më e vogël në vite vlerësohet se mund të sjellë shërbim me cilësi të ulët dhe gabime operacionale, si shkelja e protokolleve ushqimore, etj., gabime të cilat duhet domosdoshmërisht të shmangen në këtë objekt prokurimi, pasi cënon sigurinë e pacientëve.

Ndihmës kuzhinieri është vlerësuar të ketë të paktën një vit eksperience, pasi gjatë kësaj kohe ky punonjës ka fituar përvojën bazë mbi higjenën dhe sigurinë ushqimore, përgatitjen e ushqimeve sipas kërkesave specifike, njohuritë mbi veprimet teknike bazë, si përdorimi i pajisjeve specifike, teknikat e prerjes, përgatitjes paraprake të përbërësve. Përvoja të paktën prej një viti siguron që punonjësi është tashmë i trajnuar në kryerjen e detyrave funksionale dhe nuk ka nevojë për trajnim të gjatë, gjë e cila mund të ndikojë në kryerjen e shërbimit me vonesë dhe jo në kohën e caktuar, duke ulur edhe cilësinë e shërbimit.

Vitet e eksperiencës për secilin janë minimale dhe sigurojnë AK që këta punonjës që do të angazhohen për këtë procedurë prokurimi kanë eksperiencën e duhur për të përgatitur dietat përkatëse, sipas përshkrimit të tyre, në kohë dhe me cilësinë e kërkuar.

Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës në të cilat duhe të përmbushë ky shërbim.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Punësimi i punonjësve të kërkuar më sipër (përveç shoferit) pranë OE ofertues, të paktën muajin e fundit është një tregues që garanton aftësinë reale të ofertuesit për të kryer shërbimin, kapacitetin real të tij me punonjës aktivë, të cilët janë të përgatitur dhe të njohur me standartet dhe procedurat e punës që zbaton ofertuesi.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore. Mjeti mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: dokumentacion të plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje/përdorimi/shërbimi, dhe leje qarkullimi, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore si dhe të jetë i shoqëruar me certifikatën për plotësimin e kushteve teknike.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Në përputhje me kërkesën e përcaktuar në DST, "Njoftimi i kontratës", Seksioni 4: Procedura, pika 4.4, gërma A "Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto", nën-pika 4, operatori

ekonomik ofertues përveç dokumentacionit të kërkuar në pikën 2.3.4 më sipër, duhet të dorëzojë edhe certifikatë të regjistrimit të mjetit me të dhënat teknike (viti, lloji, standarti EURO).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjeti frigoriferik për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për disponimin e mjetit frigoriferik është në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018, dhe shërben për të transportuar ushqimin, duke siguruar shpërndarjen e ushqimit me cilësinë e kërkuar, në destinacionin e përcaktuar, sipas specifikimeve teknike dhe kushteve teknike të zbatimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar nga një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “S.U.O.GJ “Mbretëresha Geraldinë””, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

LOTI 2: “SHËRBIMI I GATIMIT DHE SHPËRNDARJES SË USHQIMIT PËR SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS”

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, (katering). Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik (në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM Nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) apo disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore.

Në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018 nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik. Për këtë arsye detyrimisht Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i licencuar, sipas dispozitave përkatëse ligjore dhe nën ligjore.

Licenca dhe kategoria, e përcaktuar si kriter më sipër është në përputhje dhe lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet dhe cilësinë e shërbimit, që kërkon të ofrohet nëpërmjet kësaj kontrate.

2.1.2 Operatorët ekonomikë, duhet të posedojnë të paktën një stabiliment të licensuar për prodhimin e ushqimit. Ky stabiliment duhet të jetë brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër. Objekti mund të jetë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratë qiraje ose përdorimi, ku të identifikohet dhe vendndodhja brenda bashkisë.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për disponimin e një stabilimenti të licensuar, është vendosur bazuar në nenin 19 të ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, dhe rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018, për furnizimin/shpërndarjen me produktet ushqimore në ambjentet e përcaktuara, si dhe për ruajtjen e higjenes dhe mjediset, kushteve tekniko-teknologjike dhe personelit.

Duke qenë se ushqimi duhet të jetë i gatuar rishtaz, vendodhja e stabilimentit brenda territorit të bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër, siguron gatimin dhe shpërndarjen e gatimit, në kohë, brenda standarteve dhe kërkesave të cilësisë të kërkuara. Siguria ushqimore në këtë procedurë prokurimi është një kërkesë jo vetëm teknike, por një detyrim ligjor dhe etik për të mbrojtur shëndetin e pacientëve. Transporti në distanca të gjata rrit ndjeshëm rrezikun e kontaminimit mikrobiologjik për shkak të humbjes së kontrollit mbi temperaturën, kohën e qëndrimit, sidomos në raste të trafikut, bllokimeve, kushteve atmosferike etj. Distanca e kërkuar

siguron një monitorim më efikas të kontratës./ave që do të lidhen, si dhe menaxhimin e më efektiv dhe të shpejtë të rasteve urgjente që mund të lindin.

Nga ana tjetër, stabilimenti brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër, ndikon në reduktimin e ndotjes së ajrit, pasi transporti më i shkurtër sjell më pak ndotje, më pak emetime CO₂ në mjedis.

Njesia e prokurimit gjykon që në rast duhet të kërkohej të paktën një stabiliment brenda bashkisë ku zbatohet kontrata, edhe në rastin kur shërbimi i gatimit mund të kryhet në ambientin e spitalit, pasi garantohej vazhdimësia e shërbimit edhe eksperiencë e ofertuesit në lidhje me kriteret e licensimit dhe kushtet ligjore dhe teknike që duhet të ketë një ambient ku gatuhet ushqim, vecanërisht për një target grup specifik siç janë pacientët e spitalit.

2.1.3 Operatorët ekonomikë, duhet të paraqesin një deklaratë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor, duhet të paraqesë Aktin e kontrollit të fundit të realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), ku ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”....”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjerë të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, si dhe bazuar në objektin e prokurimit, në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018, me qëllim që AK të krijojë siguri se ofertuesi gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij plotëson kushtet ligjore, të lidhura me objektin e prokurimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 datë 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomik-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më

pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se disponon dhe të paraqesë certifikatë (të vlefshme), si më poshtë si më poshtë:

SH EN ISO 22000:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

S SH EN ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

SSH EN ISO 14001:2015 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

SH EN ISO 22000:2018 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme është vendosur bazuar në rekomandimin e përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018, me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të sigurisë ushqimore.

Duke qenë se ky standart specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të sigurisë ushqimore për të mundësuar një operator, që është i përfshirë drejtpërdrejtë ose tërthorazi në zinxhirin ushqimor: të planifikojë, zbatojë, operojë, mirëmbajë dhe përditësojë një sistem që ofron produkte dhe shërbime që janë të sigurta, në përputhje me përdorimin e tyre të synuar, për të demonstruar pajtueshmërinë me kërkesat e aplikueshme statutores dhe rregullatore të sigurisë ushqimore, të vlerësojë kërkesat e klientëve për sigurinë ushqimore të miratuara reciprokisht dhe të demonstrojë konformitetin me to, të komunikojë në mënyrë efektive çështjet e sigurisë ushqimore palëve të interesuara brenda zinxhirit ushqimor; etj.;

Si dhe duke vlerësuar që të gjitha kërkesat e këtij dokumenti janë të përgjithshme dhe synohen të zbatohen për të gjitha organizatat që janë të përfshira drejtpërdrejt ose tërthorazi, në zinxhirin ushqimor, pavarësisht nga madhësia dhe kompleksiteti;

Kërkesa e mësipërme lidhet ngushtësisht me objektin e prokurimit, duke krijuar siguri që shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit do të kryhet konform standarteve të kërkuara, dhe operatori ekonomik është i aftë të identifikojë rreziqet për sigurinë ushqimore, i vlerëson ato dhe vendos masa kontrolli për t'i eliminuar apo minimizuar. Disponimi i këtij standarti garanton AK se ofertuesi ka një sistem të dokumentuar, të monitoruar dhe të auditueshëm për identifikimin dhe kontrollin e rreziqeve ushqimore, menaxhimin e pikave kritike të kontrollit (HACCP), trajnimin e personelit dhe monitorimin e higjienës. Në rast të një incidenti ushqimor, një ofertue si pajisur me këtë standart reagon më shpejt, ka sisteme gjurmueshmërie të menjëhershme për përbërësit dhe proceset, minimizon pasojat për pacientët dhe për autoritetin kontraktor.

S SH EN ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme vlerësohet një standart i rëndësishëm për tu disponuar nga ofertuesit i lidhur ngushtë me objektin e prokurimit.

Duke qenë se shërbimi objekt prokurimi përfshin përgatitje intensive të vaktevenë kuzhinë, proces i cili paraqet rrezik nga mjetet prerëse, zjarri, avujt, temperatura të larta, kimikatet e pastrimit,

transport të përditshëm të ushqimeve dhe shpërndarje në ambiente spitalore, procese ku kërkohen standarte të larta higjene dhe mbrojtje nga kontaminimi, etj., pajisja me këtë standart siguron AK që ofertuesi ka procedura të qarta për menaxhimin e rreziqeve fizike dhe mjedisore, zbaton masa parandaluese për të shmangur aksidente në punë, si dhe organizon trajnime për sigurinë e punonjësve. Ky standart siguron AK gjithashtu se ofertuesi ka një strukturë të mirëorganizuar për menaxhimin e ngjarjeve të papritura, duke ruajtur vazhdimësinë e shërbimit.

SSH EN ISO 14001:2015 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme siguron AK që ofertuesi ka procedura për menaxhimin dhe reduktimin e mbetjeve, si dhe për ruajtjen e pastërtisë së ambientit, pasi aktivitetet e gatimit dhe shpërndarjes krijojnë mbetje (organike, plastike, vajra të përdorur, detergjentë etj.). Ky standart nxit gjithashtu përdorimin e energjisë, ujit dhe lëndëve të para në mënyrë të qëndrueshme, duke ulur kostot dhe ndikimin ekologjik.

2.3.3 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të kenë jo më pak se 15 (shtatëmbëdhjetë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjësve
1.	Mercolog/Kimist/Teknolog Ushqimor (Agroushqimor)	1
2.	Kuzhinier	1
3.	Ndihmës Kuzhinier	2
4.	Punonjës shpërndarës ushqimesh në ambientet e AK	10
5.	Shofer	1
	Total	15 (pesëmbëdhjetë)

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, për Mercolog/Kimist/ Teknolog Ushqimor (Agroushqimor), Kuzhinierin, Ndihmës Kuzhinierin, Punonjës shpërndarës ushqimesh në ambientet e AK.

a) Për Mercolog/Kimist/ Teknolog Ushqimor (Agroushqimor):

- Diplomë me profesionin perkates;
- Kontratë pune (e vlefshme);
- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite.

b) Për Kuzhinierin:

- Diplomë ose çertifikatë kualifikimi për kuzhinier në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional,
- Kontratë pune si kryekuzhinier/ kuzhinier, (e vlefshme)
- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite.

c) Për ndihmës kuzhinierin:

- Kontratë pune si ndihmës kuzhinier, (e vlefshme)

- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekspseriencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 1 një vit.

d) Për punonjësit për shpërndarje ushqimi të paraqitet:

- Kontratë pune si shpërndarës ushqimi (e vlefshme).

dh) Për punonjësit Shofer, të paraqitet:

- Kontratë pune si shofer, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi, për mjetin e kërkuar, në përputhje me Legjislacionin në fuqi

Ky Kriter konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit,ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës hartuar nga AK, për llogari të së cilit po zhvillohet procedura e prokurimit. Operatorët ekonomik, me anë të stafit të kërkuar, do të kryejnë në mënyrë shteruese shërbimin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit per Spitalin.

Referuar sa më sipër, operatori ekonomik duhet të disponojë një mercollog/kimist/teknolog ushqimor (agroushqimor), i cili ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimit të perzgjedhjes se ushqimeve sipas kerkesave te Specifikimeve Teknike. Një punonjës me një profil të tillë vlerësohet i nevojshëm pasi ka ekspertizë profesionale në zinxhirin ushqimor, për të menaxhuar procesin e përpunimit të ushqimit, ruajtjen dhe magazinimin, trajtimin termik, etiketimin dhe përbërësit, si dhe kontrollin e cilësisë dhe sigurisë ushqimore. Duke qenë se ndër proceset e objektit të prokurimit, përfshihet gatimi, kuzhinieri dhe ndihmës kuzhinieri janë të lidhur ngushtë me zbatimin e këtij procesi dhe përgatitjes së dietave të përcaktuara në DST. Punonjësit për shpërndarje ushqimi dhe shoferi, lidhen ngushtë me procesin e transportit, shpërndarjes së ushqimit në oraret e përcaktuara nga AK.

Vitet e eksperiencës për mercollog/kimist/teknolog ushqimor (agroushqimor), kuzhinierin dhe ndihmës kuzhinierin janë vendosur duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e shërbimit, objekt prokurimi. Vitet e eksperiencës për secilin janë minimale dhe sigurojnë AK që këta punonjës që do të angazhohen për këtë procedurë prokurimi kanë eksperiencën e duhur për të përgatitur dietat përkatëse, sipas përshkrimit të tyre, në kohë dhe me cilësinë e kërkuar.

Përvoja e mëparshme për mercollog/kimist/teknolog ushqimor (agroushqimor) dhe kuzhinierin, të paktën 2 vite, lidhet me aftësinë në menaxhimin e një kuzhine, e cila është komplekse se një kuzhine standarte, për shkak të dietave të personalizuar. Nga ana tjetër kjo eksperiencë garanton AK se këta punonjës kanë njohuri të mjaftueshme për planifikimin e menusë, logjistikën e shërbimeve, optimizimin e burimeve (si ushqime, staf, pajisje) dhe kontrollin e cilësisë së ushqimit, si elementë thelbësorë në zbatimin e objektit të prokurimit. Përvoja e mëparshme, të paktën 2 vite, siguron AK se këto punonjës kanë aftësi menaxheriale, të cilët janë të aftë të zgjidhin situatat emergjente që mund të krijohen. Mungesa e ekesperiencës dhe një përvojë më e vogël në vite vlerësohet se mund të sjellë shërbim me cilësi të ulët dhe gabime operacionale, si

shkelja e protokolleve ushqimore, etj., gabime të cilat duhet domosdoshmërisht të shmangen në këtë objekt prokurimi, pasi cënon sigurinë e pacientëve.

Ndihmës kuzhineri është vlerësuar të ketë të paktën një vit eksperience, pasi gjatë kësaj kohe ky punonjës ka fituar përvojën bazë mbi higjenën dhe sigurinë ushqimore, përgatitjen e ushqimeve sipas kërkesave specifike, njohuritë mbi veprimet teknike bazë, si përdorimi i pajisjeve specifike, teknikat e prerjes, përgatitjes paraprake të përbërësve. Përvoja të paktën prej një viti siguron që punonjësi është tashmë i trajnuar në kryerjen e detyrave funksionale dhe nuk ka nevojë për trajnim të gjatë, gjë e cila mund të ndikojë në kryerjen e shërbimit me vonesë dhe jo në kohën e caktuar, duke ulur edhe cilësinë e shërbimit.

Vitet e eksperiencës për secilin janë minimale dhe sigurojnë AK që këta punonjës që do të angazhohen për këtë procedurë prokurimi kanë eksperiencën e duhur për të përgatitur dietat përkatëse, sipas përshkrimit të tyre, në kohë dhe me cilësinë e kërkuar.

Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës në të cilat duhe të përmbushë ky shërbim.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Punësimi i punonjësve të kërkuar më sipër (përveç shoferit) pranë OE ofertues, të paktën muajin e fundit është një tregues që garanton aftësinë reale të ofertuesit për të kryer shërbimin, kapacitetin real të tij me punonjës aktivë, të cilët janë të përgatitur dhe të njohur me standartet dhe procedurat e punës që zbaton ofertuesi.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore. Mjeti mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: dokumentacion të plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje/përdorimi/shërbimi, dhe leje qarkullimi, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore si dhe të jetë i shoqëruar me certifikatën për plotësimin e kushteve teknike.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Në përputhje me kërkesën e përcaktuara në DST, "Njoftimi i kontratës", Seksioni 4: Procedura, pika 4.4, gërma A "Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto", nën-pika 4, operatori ekonomik ofertues përveç dokumentacionit të kërkuar në pikën 2.3.4 më sipër, duhet të dorëzojë edhe certifikatë të regjistrimit të mjetit me të dhënat teknike (viti, lloji, standarti EURO).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjeti frigoriferik për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kërkesa për disponimin e mjetit frigoriferik është në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018, dhe shërben për të transportuar ushqimin, duke siguruar shpërndarjen e ushqimit me cilësinë e kërkuar, në destinacionin e përcaktuar, sipas specifikimeve teknike dhe kushteve teknike të zbatimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar nga një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Spitalin Universitar të Traumës”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Argumentimi i kriterëve të pikezuara dhe menyra e llogaritjes së pikeve:

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (në vijim “LPP”), konkretisht pika 1 e nenit 87 të LPP, ku parashikohet se: “Autoritet/entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme”, të cilat lënë në diskrecionin e AK përcaktimin e mënyrës së vlerësimit, si dhe duke vlerësuar natyrën e objektit të prokurimit për secilin lot, dhe proceset që përfshin ky shërbim, AK vlerëson më të përshtatshme dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht të favorshme, për arsyet si më poshtë (në mënyrë të përmbledhur):

Kjo metodë vlerësimi nxit konkurrencë cilësore, shmang praktikën e ofertave jo reale, pasi siguron AK se ofertuesit kanë përllogaritur me saktësi burimet dhe shpenzimet, lejon përfshirjen e elementëve të qëndrueshmërisë/kostot mjedisore.

Vendosja e kriterëve sociale dhe mjedisore në këtë procedurë prokurimi synon të sigurojë një shërbim që jo vetëm përmbush kërkesat teknike, por gjithashtu mbështet objektivat e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale, në përputhje me ligjislacionin kombëtar dhe direktivat e BE-SË. Përfshirja e këtyre kriterëve ndihmon në përmirësimin e kushteve të punës, zvogëlimin e ndikimit mjedisor përmes praktikave të gjelbra dhe menaxhimit të mbejeteve, të gjeneruara nga ushqimi pro jo vetëm, sigurimin e një vlerë të qëndrueshme për parandalim publike, përtej çmimit të ofertës.

Detajimi i shpërndarjes së pikëve për secilin lot të procedurës së prokurimit është vlerësuar si vijon:

Shpërndarja e pikëve, për cdo Lot si më poshtë:

Kriteri:

1. **Çmimi** **70 pikë**
2. **Planveprimi i Parandalimit të gjenerimit të mbejeteve nga ushqimi [0- 10] pikë**

3. Reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe përdorimi i paketimit të qëndrueshëm

– [0-10] pikë

4. Transporti ekologjik

[0-10] pikë

Argumentimi i kriterëve të pikezuara dhe menyra e llogaritjes së pikeve:

1. Çmimi:

70 pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

2. Planveprimi i Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi [0- 10] pike

Argumentim: Ofertuesi duhet të përpilojë një plan veprimi për parandalimin e mbetjeve ushqimore. Ky plan përfshin (por pa u kufizuar në):

- një analizë e të gjitha proceset për të identifikuar llojet dhe burimet e gjenerimit të mbetjeve ushqimore;
- kryerjen e matjeve të sasive të mbetjeve ushqimore në mënyrë të vazhdueshme ose periodike (duke u bazuar në kontrata të mëparshme apo analiza empirike profesionale);
- hartimin e strategjive për parandalimin e teprimit të ushqimeve, duke përfshirë (por jo vetëm) garantimin e ruajtjes së ushqimit në kushtet e duhura, magazinim efikas, blerje rregullisht në sasi të duhura të lëndës së parë me të cilat do të përgatiten dietat, angazhim të oferteutit në projekte sociale, etj.

Kërkesa për planveprimin e Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi është një dokument kryesor në zbatimin e kontratës, i cili do të shoqërohet deri në fund të atë, pasi zbatimi i masave të tilla përbën një element të rëndësishëm në vlerësimin e cilësisë së shërbimit, duke reflektuar angazhimin për efikasitet ekonomik dhe mbrojtje mjedisore.

Parandalimi i gjenerimit të mbetjeve ushqimore përbën një masë të rëndësishme për garantimin e një shërbimi efikas, ekonomik dhe të qëndrueshëm. Në kontekstin e ofrimit të shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, minimizimi i ushqimit të papërdorur ndihmon në uljen e kostove operative, përmirëson higjienën në ambientet spitalore duke shmangur rreziqet nga kontaminimi dhe redukton ndikimin negativ në mjedis. Ofruesit e shërbimit inkurajohen të paraqesin masa konkrete për planifikimin e racioneve, përdorimin optimal të lëndëve të para dhe në përputhje me parimet e prokurimit të gjelbër.

Ushqimi i hedhur përbën një burim të madh ndotjeje, pasi gjatë dekompozimit mbetjet organike çlirojnë gazra serrë, elemente të dëmshëm mjedisor.

Nga ana tjetër, duke qenë se hedhja e ushqimit ka ndikim në aspektin social e etik, inkurajimi i praktikave si dhurimi i ushqimit të paprekur (në kushte të sigurta), bashkëpunimi me OJF për mbështetjen e grupeve vulnerabël, etj., mund të ndihmojë komunitetet në nevojë. Operatore ekonomike me përvorje në dhurimin e produkteve ushqimore kanë qasje me sociale dhe ndikojnë

drejteperdrejte ne prokurimin e qendrueshem duke optimizuar shpenzimet me ane te shperndarjes se ushqimeve per kategori sociale ne pamundes.

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument të shkruar, ku të përfshihen përcaktimet e mësipërme, por pa u kufizuar në to.

Vleresimi do te behet si me poshte:

a. Cilesia e planveprimit ne aspektin mjedisor: 0- 5 pike

b. Cilesia e planveprimit ne aspektin social: 0-5 pike

**Vleresimi me pike do te behet duke analizuar perfshirjen e elementeve te argumentimit duke mos u kufizuar ne to. Me 0 pike do te vleresohen operatoret ekonomike te cilet nuk paraqesin fare planveprim ose nje planveprim qe nuk permban asnje te dhene te pershkruar ne argumentim. Ndersa pikezimi 1-5 pike do te behet duke u bazuar ne cilesine dhe pershkrimin te elementeve te argumentimit.*

3. Reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe përdorimi i paketimit të qëndrueshëm – [0-10] pikë

Argumentim: Ofertuesi duhet të zbatojë një plan për reduktimin e ambalazheve të panevojshme dhe përdorimin e paketimit të qëndrueshëm.

Ky plan duhet të përfshijë (por pa u kufizuar në):

- përpilimin e inventarit të mbetjeve: duke analizuar të gjitha proceset për të identifikuar llojet dhe burimet e gjenerimit të mbetjeve të tjera (përveç mbetjeve ushqimore);
- reduktimin e mbetjeve në blerjen e lëndëve të para, me të cilat do të përgatiten racionet (dietat): zgjedhja e llojit të duhur të paketimit për të reduktuar mbetjet (p.sh. paketim të ripërdorshëm), paketim të riciklueshëm dhe kthimi i paketimit për ripërdorim vetëm në raste kur kjo është e mundur dhe nuk çënon sigurinë e ushqimit;
- reduktimin e mbetjeve në shërbimin e kateringut: shmangia e artikujve me ambalazh dytësor të panevojshëm ose të tepërt, përdorimi i kontenitorëve që mund të rimbushen (për erëza), etj.

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument të shkruar, ku të përfshihen përcaktimet e mësipërme, por pa u kufizuar në to.

Në kuadër të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe zbatimit të politikave të prokurimit të gjelbër, zgjedhja e llojit të duhur të paketimit gjatë blerjes së produkteve ushqimore përbën një element kyç në reduktimin e mbetjeve dhe ndikimit negativ në mjedis.

Paketimi i thjeshtë, funksional dhe i biodegradueshëm ndihmon në:

- Reduktimin e volumit të mbetjeve të ambalazhit, të cilat përndryshe përbëjnë një ngarkesë të konsiderueshme për mjedisin, zvogëlimin e përdorimit të materialeve plastike dhe ambalazheve dytësore (paketime të panevojshme brenda paketimeve), të cilat janë shpesh jo të riciklueshme dhe pa funksion real ruajtës;
- Sigurimin e ruajtjes më të mirë të produkteve ushqimore, duke garantuar jetëgjatësi më të madhe, kontroll cilësor dhe mbrojtje ndaj ndotjes apo dëmtimeve gjatë transportit dhe shpërndarjes;

Vleresimi do te behet si me poshte:

a. Plani i veprimit per ambalazhimin e panevojshem dhe metodologjia e mbledhjes dhe perpunimit te ketij ambalazhi 0-5 pike

**Vleresimi me pike do te behet duke analizuar perfshirjen e elementeve te argumentimit duke mos u kufizuar ne to. Me 0 pike do te vleresohen operatoret ekonomike te cilet nuk paraqesin fare planveprim ose nje planveprim qe nuk permban asnje te dhene te pershkruar ne argumentim. Ndersa pikezimi 1-5 pike do te behet duke u bazuar ne cilesine dhe pershkrimin te elementeve te argumentimit.*

b. Lloji i paketimit i zgjedhur i cili mund te jete i biodegradueshem ose i riciklueshem 5 pike. Nese per kete kriter nuk paraqitet asnje dokument, ose asnje dokument qe te vertetoje se paketimi i propozuar nuk ka elemente pro mjedisore vleresohet me 0 pike.

- Ky kriter do te vleresohet bazuar ne dokumentacion faktik sic eshte nje marredhenie e deshmuar me nje prodhues apo distributor te paketimeve ushqimore. Ku marredhenia eshte me distributor te autorizuar do te vertetohet marredhenia e distributorit me prodhuesin. Ne aktet provuese duhet te pershkruhet natyra e paketimit nese eshte e riciklueshme, e biodegradueshme apo e ndonje lloji tjetër, miqesore me mjedisin.*

4. Transporti ekologjik [0-10 pike]

Argumentim: Ofertuesi duhet të dëshmojë se shërbimi i transportit të ushqimit deri në ambientet e AK, do të realizohet me mjete transporti me emetime të ulëta, si më poshtë:

- përdorimin e mjeteve të transportit frigoriferik te llojit elektrik ose hybrid ose cdo lloj tjetër automjeti transporti i cili ka emetimin me te ulet te co2 te provuar me dokumentacion.

Shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për spitalet është një proces i përditshëm, me frekuencë të lartë shpërndarje, përdorim të mjeteve transportuese dhe konsum të konsiderueshëm paketimi dhe energjie, duke sjellë ndikime direkte në mjedis.

Kërkesa për përdorimin e mjeteve frigoriferike elektrike/ hibride dhe me pak emetime kontribuon jo vetem në uljen e ndotjes në mjedisin ku këta mjete qarkullojnë, por edhe në zvogëlimin e ndotjes globale dhe përmbushjen e objektivave të klimës. Automjeti i propozuar do te levize minimalisht tre here ne dite per shperndarjen ushqimore, keshtu qe frekuenca e levizjes dhe ndotja eshte relativisht e larte. Per kete arsye, automjetet me emetime te uleta jane me miqesore me mjedisin.

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë, dokumentacionin e kërkuar në pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, si dhe:

- certifikatë të regjistrimit të mjetit me të dhënat teknike (viti, lloji, standarti EURO)

Vleresimi do te behet si me poshte:

- Nese OE disponon nje automjet elektrik vlerësohet me 10 pikë, nëse disponon një mjet hybrid vlerësohet me 5 pikë dhe nëse disponon automjet tjetër me emetim të ulët vlerësohet nga 0 (nëse emetimi është i lartë) deri ne 4 pikë.

Baza ligjore per vendosjen e ketyre kriterëve:

Neni 79

Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;

b) efikasiteti të energjisë;

c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

Neni 87

Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

VENDIM Nr. 285, datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK

Neni 25 Kriteret e kualifikimit

3. Autoritetet/entet kontraktore janë të detyruara që në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të LPP-së, si edhe në hartimin e specifikimeve teknike, sipas parashikimeve të nenit 36, të LPP-së, të zbatojnë, përveç këtyre rregullave për prokurimin publik, edhe detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji; b) **Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;** c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Neni 45 Kriteret për shpalljen e ofertës fituese

1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së **dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.**

METODOLOGJI UDHËZUESE PËR ZBATIMIN E PROKURIMIT PUBLIK TË GJELBËR NË SHQIPËRI

4. Kategoritë e produkteve dhe shërbimeve dhe kriteret të përzgjedhura të gjelbra të zbatueshme në prokurimin publik (PPGJ)

3. Shërbime të ushqimit dhe kateringut

Fleta udhëzuese #3: Ushqimi dhe shërbimet e kateringut.

NJËSIA E PROKURIMIT